

Angazhim ndaj rregullores kushtetuese liberale dhe demokratike të Republikës Federale të Gjermanisë

për aplikimin e lejes së qëndrimit në përputhje me nenin 104c, paragrafi 1, fjalia 1, nr.1

- 1) Deklaroj se besoj në rregulloren kushtetuese liberale dhe demokratike të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë. Në veçanti, pranoj se:
 - a) Populli ka të drejtë të ushtrojë pushtetin shtetëror
 - nëpërmjet zgjedhjeve dhe votimeve,
 - përmes organeve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore.Populli do të zgjedhë përfaqësuesit e tij nëpërmjet votimit universal, të drejtpërdrejtë, të lirë, të barabartë dhe të fshehtë.
 - b) Legjislacioni është i lidhur me rendin kushtetues. Pushteti ekzekutiv dhe gjyqësor janë të lidhur me ligjin dhe drejtësinë.
 - c) Duhet të formohet dhe ushtrohet një opozitë parlamentare.
 - d) Qeveria duhet të përgjigjet për veprimet e saj para përfaqësuesve të popullit. Qeveria mund të votohet dhe të zëvendësohet.
 - e) Gjykatat janë të pavarura.
 - f) Është e përjashtuar çdo formë qeverisjeje arbitrare dhe e dhunshme.
 - g) Të drejtat e njeriut janë të paprekshme.
 - h) Ligji Themelor garanton dinjitetin dhe barazinë e të gjithë njerëzve. Një veprim me qëllime antisemite, raciste, ksenofobe ose qëllime tjera jo njerëzore nuk është i përputhshëm me këtë ligj dhe është në kundërshtim me këtë deklaratë.
- 2) Deklaroj se nuk synoj ose mbështes, dhe nuk e kam bërë këtë në të kaluarën, asnjë nga qëllimet e mëposhtme, të cilat
 - a) janë kundër rregullores kushtetuese liberale dhe demokratike, ekzistencës ose sigurisë së qeverisë federale ose të një rajoni, ose
 - b) kanë për qëllim të rrezikojnë në mënyrë të paligjshme sjelljen zyrtare të organeve kushtetuese të Federatës ose të një rajoni ose të anëtarëve të tyre, ose
 - c) vënë në rrezik interesat e jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë përmes përdorimit të dhunës ose veprimeve përgatitore ndaj saj, ose
 - d) kanë si qëllim një veprim antisemit, racist, ksenofob apo tjetër qëllim jo njerëzor.
- 3) Kam marrë, lexuar dhe kuptuar "Fletën informuese mbi rregulloren kushtetuese liberale dhe demokratike".

Vendi dhe data

Nënshkrimi